



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

---

Numri i lëndës: 2021:205472

Datë: 05.09.2022

Numri i dokumentit: 03390351

PPP.nr.1/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar përbarues, duke vepruar sipas lëndës së përbarimit të Kreditorit ... me seli në Prishtinë, kundër Debitorit E. K. nga fshati ... Komuna Kaçanik, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seance gjyqësore më datë 05.09.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET**, prapësimi i debitorit E. K. nga fshati ... Komuna Kaçanik i ushtruar më datë 05.01.2021, kundër Urdhërit për lejimin e ekzekutimit të përbaruesit privat P.nr.270/2020 i datës 16.12.2020, në tërsi SI I PABAZUAR.

**DETYROHET**, debitori që ta bëjë ekzekutimin e Aktgjykimit C.nr.208/07 të datës 04.05.2011 si dhe të i paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore ,të cilat do të llogariten nga përbaruesi privat, këto pagesa do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Kreditori ... me seli në Prishtinë, më datë 16.12.2020, e ka dorëzuar propozimin për përbarim në zyrën e përbaruesit privat Sheremet H. Livoreka me seli në Kaçanik tani në Ferizaj, ndaj debitorit E. K. nga fshati ... Komuna Kaçanik.

Kreditori me këtë propozim ka kërkuar nga përmbaruesi që të lejohet përmbarimi i propozuar dhe të obligohet debitori që palujtshmërit që evidentohen sipas Certifikatës së pronës dhe kopjet e planit me numër të lëndës ... e datës 30.10.2020 e lëshuar nga Komuna Kaçanik, të lirohen nga njerëzit dhe sendet dhe ti dorëzohen në posedim kreditorit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbarusi privat me datën 16.12.2020, e ka nxjerrur urdhërin për përmbarim me të cilin e ka lejuar përmbarim, poashtu me këtë urdhër e ka udhëzuar debitorin që të paraqes prapësim në afat prej 7 ditësh.

Përmbaruesi privat debitorit ia ka dorzuar propozimin për përmbarim me të gjitha provat më datën 22.12.2020, ndërsa debitori më datën 05.01.2021 ndaj urdhërit përmbarues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar dhe të refuzohet propozimi për përmbarim në tërsi si i pa bazuar dhe i paligjshëm për shkak se në rastin konkret kemi shkelje të dispozitave ligjore, pasi që asnjëher nuk më është dhënë mundësia për të kundërshtuar këtë konkluzion.

Përmbaruesi privat një kopje të prapësimit ia ka dorzuar kreditorit, kreditori në afatin e paraparë ligjorë ka ushtruar përgjigje në prapsim, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapsimin e debitorit të datës 05.01.2022 si të pa bazuar dhe ta vërtetoj urdhërin përmbarimore të përmbaruesit privat numër P.nr.270/20 të datës 11.12.2020.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, prapësimit të debitorit të njejtin e refuzoi në tërsi si të pa bazuar për arsye se debitori me prapësim nuk ka bashkangjitur asnjë provë, ashtu siq është paraparë me nenin 69 par 4 të LPP-së me të cilën dispozitë është parapr se bazat për prapësim duhet të mbështet me prova të duhura, provat për prapsim duhet të dorzohen me shkrim përndryshe prapsimi do të refuzohet.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës vleron se nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e parapara në bazë të nenit 71 nga pika (1.1 ) deri tek pika (1.12) të LPP-së, andaj gjykata nga arsyet e cekura më lart vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i analizoi pretendimet e kreditorit të paraqitura me prapësim dhe këtyre pretendimeve ua fali besimin sepse kreditori propozimin për përmbarim e ka mbështetur në dokumentet përmbarimore të cilat janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e debitorit të paraqitura me prapësim, mirpo këto pretendime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse debitori prapësimit, nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën do ta vërtetonte se prapësimi është i bazuar.

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore të cilat do të llogariten nga përmbaruesi privat si dhe duke u bazuar në nenin 13 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

PPP.nr.1/21 , datë 05.09.2022

Gjyqtari,  
**RIZA LIVOREKA**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Ekspeduar më datën 05.09.2022

Kreditorit 1x1

Debitorit 1x1